



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e **Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF)**, e mbajtur më **13.6.2024**, me fillim në orën **10:05**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, **Arbër Zenuni**.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Përshëndetje nënkryetar **Fatmir Iska**. Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, të gjithë ju të pranishëm! E hapim mbledhjen e **gjashtë (6)** të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2024. Në konsultim me kryetarin e Komunës, kemi përgatitur këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), 2025-2027;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale, P- 02302-0, P-02299-0, ZK – Rahovec;
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit, 01 Nr. 2918, i datës 26.10.2018, për dhënien e pëlqimit për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për ndërtimin – restaurimin e Shtëpisë së Masakrës në Krushë të Madhe;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të KPF-së, a kemi ndonjë pikë tjetër shtesë, apo diskutim? Nëse jo, atëherë rendin e ditës e vendosim në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Konstatoj që me shumicë votash (5 vota “për”), votohet rendi i ditës për sot.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A ka dikush ndonjë vërejtje rreth procesverbalit? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim! Kush është “për”?... Konstatoj që unanimisht (5 vota “për”) votohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), 2025-2027:

Afrim Limani: I nderuari kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së! Më 15 maj ka ardhur qarkorja e parë buxhetore financiare, që përcakton kufijtë dhe tavanet buxhetore për buxhetin e Komunës së Rahovecit. Sipas qarkores së parë buxhetore, buxheti i Komunës së Rahovecit në total, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake, do të jetë: 20.982.000€. Nëse bëjmë krahasim me vitin 2024, atëherë është një rritje e buxhetit prej 1.158.000€, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake. Ne e presim edhe qarkoren e dytë buxhetore, e cila vjen në korrik dhe është përfundimtarja. Granti i Administratës është 9.168.000€, që ka një rritje prej 681.920€. Granti i Arsimit është 7.330.000€, në krahasim me vitin 2024, ka rritje prej 191.689€. Granti i Shëndetësisë: 2.452.200, që në krahasim me vitin 2024 ka një zbritje prej 84.000€. Në total, buxheti është: 20.982.000€. Buxheti, në kategori ekonomike, përafërsisht, do të jetë kështu: pozicioni i pagave do të jetë 10.552.000, në krahasim me vitin 2024, kemi një rritje prej 125.000€. Mallra dhe Shërbime: 2.761.000, një rritje prej 294.000. Komunalitë mbesin të njëjta prej 390.000. Subvencione kemi: 1.010.000 dhe janë të rritura prej 120.000€. Investimet kapitale: 6.268.000 dhe që kanë një rritje prej 617.000€. Ky

është në total buxheti i Komunës së Rahovecit, për vitin 2025. Në fund e kemi edhe buxhetimin gjinor për gra, që pretendojmë në vitin 2025 të kemi një rritje deri në 55.000€. Në e-maillet e juaja e keni edhe një dokument, që sipas programeve dhe kategorive ekonomike ta dini shpërndarjen e buxhetit.

Burim Krasniqi: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për ekzekutivin, kolegët, monitoruesit dhe për të gjithë që jeni këtu! Drejtor, viteve të tjera ka ardhur edhe qarkorja buxhetore, sivjet, në e-maile nuk e kemi pranuar qarkoren buxhetore. E kemi pranuar vetëm propozimin për KAB-in dhe buxhetin sipas qarkores, por jo edhe qarkoren buxhetore. Nuk e di pse nuk ka ardhur, por konsideroj që për Kuvend është mirë ta kemi qarkoren buxhetore. Këtu e kemi ndarjen buxhetore sipas kategorive ekonomike, por jo edhe buxhetin, sepse ende pa kaluar qarkorja e dytë buxhetore nuk dihen të dhënat e sakta që mund të bëhet shpërndarja. A mund të miratohet KAB-i pa buxhetin dhe pa kaluar kah qarkorja buxhetore? Apo duhet ta aprovojmë vetëm si qarkore dhe jo si KAB, sepse këtu kërkohet të votojmë për shqyrtimin dhe miratimin e KAB-it 2025-27 dhe realisht buxhetin nuk e kemi dhe gjërat mund të ndryshojnë në qarkoren e dytë buxhetore dhe i bie që jemi duke miratuar diçka që nuk është finale. A jemi në rregull proceduralisht nëse sot, ose në seancë, miratojmë KAB-in. Te të hyrat, sipas KAB-it, i kam disa pyetje dhe shpjegime që i pres në seancë t'i kemi. Te tatimi në tokë, është interesant që këtë vit janë paraparë 276.704€ dhe nuk besoj që do të ketë ndonjë të hyrë të tatimit në tokë, për shkak të mungesës së vlerësimit të pronave dhe të trashëgimisë, por, në 2025 ka një rënie për 30%, pse është kjo rënie? Te Shërbimet Publike, të hyrat nga shitja e mbeturinat, vetëm në 2025 janë 150.000 dhe viteve të tjera nuk ka. Çka është kjo, në kuptimin e saj? Te Drejtoria e Bujqësisë, i kemi të hyrat nga participimi 30.000€ për çdo vit. A llogaritet që përsëri do të ketë shpërndarje bujqësore që duhet të participojnë edhe bujqit, apo kërkohet participim te subvencionimi i imputeve. Nëse kërkohet subvencionim te imputet, mendoj që është gabim, sepse ju mund t'ua jepni vetëm subvencionin atyre dhe jo bujku të detyrohet të blejë edhe impute të tjera. Te urbanizmi, vetëm në 2025 janë të parapara 8000€ për legalizim dhe në asnjë vit tjetër. A do të ketë afat legalizimi vetëm në 2025 me ligj, apo pse është e paraparë kështu? Një shqetësim pak më ndryshe, te qarkorja buxhetore, parashihet që për numër të popullsisë 98% e buxhetit shpërndahet. E kemi regjistrimin e fundit dhe sipas regjistrimit të fundit 2011, Kosova i ka pasur 1.780.021 banorë, ndërsa Rahoveci 56.208 banorë dhe që te ky grant, Rahoveci ka participuar me 3.16% në bazë të numrit banorëve. Regjistrimi i fundit i popullsisë (dëshiroj që të jem gabim), nëse Kosova i ka 1.6 milion banorë dhe sipas informatave, Rahoveci i ka nën 40.000 banorë, ekziston mundësia që rreth 0.7% të reduktohet granti si rezultat i numrit të popullsisë, që kur e kthejmë në para, i bie të jetë rreth 1.5 milion€. Planifikimi 2025-26-27, a do të afektohet nga regjistrimi i numrit të popullsisë? Apo do të ndryshohet formula e shpërndarjes së grantit qeveritar? Është një shqetësim! A e keni diskutuar me Ministrinë e Financave dhe me Asociacion se si të rregullohet kjo punë?

Defrim Kafexhiu: Përshëndetje, kryesues! I nderuari nënkryetar, kolegë, drejtorë! E kam një pyetje për drejtorin të çështja e subvencioneve. Për vitin 2025, subvencionet parashikohet të jenë mbi 1.000.000€. Te Shërbimet Publike për vitin 2025, janë të planifikuar 110.000€ për subvencione, ku shkojnë këto mjete dhe në çfarë forme shpërndahen? Pyetja tjetër: Pse nuk po e bëni publike shpërndarjen e subvencioneve te OJQ-të? Sipas KAB-it, sa mjete planifikohen të ndahen për projektin e sheshit qendror të qytetit?

Afrim Limani: Nuk e kam vërejtur tek e-maillet, sepse qarkorja buxhetore duhet gjithsesi të shpërndahet. Ky është një gabim teknik, ndoshta edhe i imi. Sido që të jetë, është një gabim që nuk bën të ndodhë. Gjithsesi, për Kuvend do ta keni. Në parim kjo duhet të votohet për kufijtë buxhetorë, të cilët i dimë sipas qarkores së parë buxhetore. Buxheti është i shpërndarë në kategori, e kemi edhe grantin specifik të arsimit, të shëndetësisë dhe në parim, sipas ligjit, kemi të drejtë ta votojmë buxhetin. Si rregull, paraprakisht mblidhemi bordi i drejtorëve dhe bëjmë një planifikim të të hyrave, kuptohet, sipas llojit të të hyrave. Ne e kemi bërë një plan, e kam dërguar në ministri. Departamenti i Buxhetit, sipas ligjit, na ka caktuar se sa do të kemi të hyra. Në total, shifrat kanë ardhur prej tyre. Planifikimin që e kemi bërë në bazë të analizave tona, është 2.3 milion dhe përafërsisht për 300 mijë € ka zbritur. Në tatim, në tokë dhe pronë, ata i caktojnë limitet. Me këtë gjë, jemi detyruar të bëjmë një zbritje në total, sepse është një vlerë e madhe. Te të hyrat për legalizim të objekteve, është një gabim teknik. "Hallall" ju qoftë që e keni vërejtur, ne jemi tre vetë dhe nuk e kemi parë. Sa i përket shqetësimit tuaj, të njëjtin e kemi menduar edhe ne. Tani, me regjistrimin e fundit, thonë që ka rënë në mënyrë të ndjeshme numri i popullsisë. Buxheti për komunat, në nivel qendror, ndahet 10%. Nëse ka zvogëlim të popullsisë edhe në komunat e tjera, atëherë përafërsisht buxheti mbetet i njëjtë. Nëse numri i popullsisë është ulur vetëm te ne, në të tjera komuna jo, atëherë ne dëmtohem si komunë.

Burim Krasniqi: Drejtor, kur e përmenda çështjen e popullsisë, të them të drejtën i kam marrë në konsideratë të dyja: Sipas informatave, prej 1.8 milion në nivel vendi, të jemi në 1.6 milion dhe duke e pasur në konsideratë që Komuna e Rahovecit nuk e kalon 40 mijëshen. Kjo është ajo që diskutova.

Afrim Limani: E thashë, nga niveli qendror, ndahen 10% të planifikimit të buxhetit për komuna. Nëse ka zvogëlim në të gjitha komunat, atëherë do të jemi në rregull. Qeveria duhet të bëjë diçka në të mirë. Defrim, subvencionet në 2025 i kemi rritur 110.000€. I kemi rritur për shkak të ndryshimit të planit kontabël, tani edhe shërbimet e varrimit paguhen nga subvencionet. Subvencionet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike i kemi rritur për faktin që janë shërbimet e varrimit dhe shërbimet publike e kanë edhe një projekt tjetër, furnizim me gypa pvc, që sipas ligjit paguhen në kuadër të subvencioneve. Sa i përket projektit të sheshit, në vitin 2025, do ta mbulojmë totalisht me buxhet.

Defrim Kafexhiu: Për këtë arsye, më çudit Komuna e Rahovecit, sepse është më transparentja, por te subvencionimi i OJQ-ve nuk është publike shuma e subvencionimit të tyre.

Afrim Limani: Nuk e kam parë raportin e publikuar, por unë e di që të gjitha publikohen. Në mënyrë analitike janë të specifikuar të gjitha në raport. Raportet e njëjta i dorëzojmë në Ministri të Financave.

Burim Krasniqi: Drejtor, një kërkesë: Korniza e dytë buxhetore vjen në korrik, buxheti për miratim duhet të vije në seancën e gushtit. Të lutem, ta kemi mundësinë që raportin financiar 6-mujor, ta kemi një seancë para buxhetit. Ta kemi më të qartë se çka do të diskutojmë rreth buxhetit.

Afrim Dina: Faleminderit, kryesues! Në pyetjen e Defrim Kafexhiut, drejtori mendoj që nuk është publikuar lista e përfituesve që kanë qenë aty. Nga viti 2023-2024, nuk janë publikuar shumat që kanë përfituar OJQ-të. Çdo herë është bërë publike lista e OJQ-ve që e kanë plotësuar dokumentacionin. Nuk është problem që të publikohet edhe shuma, mirëpo kështu ka ndodhur edhe më herët dhe është vazhduar tutje.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Nëse nuk kemi edhe diçka tjetër, e vendosim në votim pikën. Kush është “për”?... Atëherë, unanimisht (4 vota) votohet pika e dytë.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale, P-02302-0, P-02299-0, ZK – Rahovec:

Afrim Oruqi: Faleminderit, kryesues! I nderuari nënkryetar, kolegë, anëtarë të KPF-së. Bazuar në ligjet e aplikueshme, Kryetari i Komunës ju propozon vendimin që t’i jepet në shfrytëzim afatgjatë deri në 25 vjet firmës “Rahoveci Solar Energy”, me nr. biznesi 811984500, me seli në Prishtinë. Bëhet fjalë për parcelat 02302-0, P-02299-0, zk – Rahovec. Pronat e paluajtshme jepen në shfrytëzim për vendosjen e paneleve solare. Sipas rekomandimeve të komisionit, është zhvilluar një proces ku është marrë pëlqim prej Kuvendit dhe më pas komisioni i formuar nga Kuvendi, ka kryer punën e vet. Ka pasur shprehje të interesit, fillimisht 2 të interesuar, në fund është tërhequr një palë dhe po ju paraqesim para juve fituesin e propozuar prej komisionit, me numër protokollit 1737, të datës 28.5.2024. Afati për shfrytëzimin e pronës fillon të rrjedhë nga data 1.8.2024 dhe përfundon më 1.8.2049, si dhe pas përfundimit të kontratës, prona do t’i kthehet komunës. Çmimi i dhënies në shfrytëzim është 2539.78€ për muaj.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! A keni ndonjë gjë rreth kësaj pike? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (4) votohet edhe pika e tretë.

4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit, 01 Nr. 2918, i datës 26.10.2018, për dhënien e pëlqimit për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për ndërtimin – restaurimin e Shtëpisë së Masakrës në Krushë të Madhe;

Afrim Oruqi: Faleminderit! Para jush keni vendimin për shfuqizimin e vendimit me nr. 01/2918, i datës 26.10.2018, për dhënien e pëlqimit për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për ndërtimin – restaurimin e Shtëpisë së Masakrës në Krushë të Madhe. Me këtë vendim, shfuqizohet vendimi me nr. prot. 01 nr.2918, i datës 26.10.2018, për dhënien e pëlqimit për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për ndërtimin – restaurimin e Shtëpisë së Masakrës në Krushë të Madhe.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit, kryesues! Nëse ka mundësi, drejtori të na japë pak më shumë informata. Vendimi është i vitit 2018 dhe tani, nëse ka mundësi të jemi në dijeni përse jemi duke e shfuqizuar, nuk na duhen numrat e protokollit dhe a është bërë restaurimi tek ajo shtëpi?

Burim Krasniqi: Në momentin që shfuqizohet ky propozim-vendim, përpos asaj që pyeti Defrimi, a priten veprime të tjera? Është vendi i paktë që ka mbetur, i cili mund të prezantojë gjerat e vendeve të masakrave të

ndodhura në Krushë. A planifikohen veprime të tjera? Nëse ne e shfuqizojmë një vendim për një arsye, a pritet të merret ndonjë vendim tjetër, të vije ndonjë propozim tjetër ndërkohë?

Afrim Oruqi: Në pyetjen e kuvendarit Defrim Kafexhiu: Në vazhden e përpjekjeve të kryetarit të Komunës, në mandatin e kaluar, kemi marrë vendim për pëlqim për shpronësim, duke i ndjekur procedurat është vlerësuar prona. Faktikisht, në terren bëhet fjalë për një sipërfaqe të vogël, sipas certifikatës së pronës bëhet fjalë për 90 ari, në këto 90 ari janë dhjetëra pronarë në terren me shtëpi të banimit. Për shkak të pakënaqësisë së pronarëve faktit dhe ligjor në terren dhe vazhdueshëm ka pasur pakënaqësi që të na lejojnë ta vazhdojmë restaurimin. Shtëpia e Masakrës, fatkeqësisht përkundër përpjekjeve tona të vazhdueshme, nuk është restauruar ende. Me pronarin faktik kemi arritur ta ruajmë së paku ashtu siç ka qenë edhe pse ka pasur plane të tjera prej 3 pronarëve faktikë, që ta krijojnë një qasje për shtëpitë e veta, të cilët nuk figurojnë në letër. Pas këtyre negociatave me banorë dhe bashkë me zyrën ligjore, e kemi vlerësuar që fillimi ka qenë afati i ankimit prej 30 ditësh, që palët t'i drejtohen gjykatës administrative, për shkak të çmimit të ulët sipas vlerësimit të tyre. Jemi në momentin kur vendimin e kemi kthyer për shfuqizim dhe më pas, pas momentin të ligjshmërisë, do t'ju drejtohem për vendim për shpallje me interes të përgjithshëm. Qëllimi i vetëm është që kjo pronë të ruhet dhe kjo shtëpi të restaurohet.

Defrim Kafexhiu: Vendimi është 6 vjet i vjetër dhe për shkak të këtyre rokadave, a mban dikush përgjegjësi apo jo? Ti si jurist që je, besoj që ma jep një përgjigje!

Afrim Oruqi: Pas 18 vjetësh, kryetari i Komunës i ka propozuar këtij Kuvendi për të marrë pëlqim për shpronësim. Aty, gjendja faktike dallon prej gjendjes ligjore. Ne e dimë se çka kemi "hjekë" me ata pronarë që banojnë atje, që bashkërisht të vijmë deri te dakordimi për shpronësim. Deri në kohën e vlerësimit, vazhdimisht kemi tentuar dhe kemi ndarë mjete për restaurim dhe për mbrojtje për atë shtëpi. Kam pritur që dikush prej juve të na falënderojë për këtë propozim, për përgjegjësi mund ta lëmë një datë ose orë tjetër, duke e ftuar dikë që merr vesh në këto gjëra.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit drejtor për mundin e vazhdueshëm që po e jepni, për gjëra të mira që i keni bërë. Për diçka që besoj nuk është në rregull, e kam të drejtën për pyetje. Sa mjete i ka ndarë komuna përgjatë këtyre viteve të tentimit për të bërë diçka?

Afrim Oruqi: Ne i kemi siguruar fillimisht mjetet për shpronësim. Çdo vjet i kemi ndarë nga 50 mijë € për shpronësim të pronave. Pas çdo viti që i kemi ndarë këto mjete, asnjëherë nuk kemi mundur t'ia nisim punës së restaurimit. Ende jemi duke tentuar dhe nuk do ta përfundojmë mandatin pa e përfunduar këtë punë.

Burim Krasniqi: Angazhimin dhe mundin, secili në pozicionin e vet e ka për obligim, sepse për këtë gjë paguheni. Ne si asambleistë ndoshta nuk ia qëllojmë fort në pyetje, por edhe përgjigja duhet të jetë më solide, jo ligjërata. Besoj që i kemi kaluar disa procedura të ligjëratave. Te çështja e trashëgimisë, a është e definuar apo keni ende probleme, nëse nuk është bërë bartja, ajo është një parcelë në tërësi me shumë trashëgimtarë dhe me shumë sfida. Me gjithë mundin e madh që e keni bërë gjatë kësaj kohe, së paku çështjen e trashëgimisë a e keni të rregulluar, që kur të vijmë te shpronësimi, trashëgimia të jetë e rregulluar?

Afrim Oruqi: Bashkë me përfaqësuesit faktikë të këtyre parcelave atje, jemi në koordinim që në momentin e shfuqizimit nuk të vije ligjshmëria, do të mundohemi bashkë ta ndajmë parcelën, ta krijojmë një parcelë të re me numër dhe sipërfaqe të re dhe kur të jemi në Kuvend, ta dimë saktësisht se për sa ari bëhet fjalë. Do të mundohemi që brenda këtyre javëve, duke u bazuar në ligj, ta rregullojmë edhe punën e trashëgimisë.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! A keni ndonjë gjë rreth kësaj pike? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (4), votohet edhe pika e katërt.

5. Të ndryshme:

Burim Krasniqi: E kam një çështje rreth një organizimi që Rahovecin e bën krenar. Është një organizim që fatbardhësisht njihet ndërkombëtarisht, është çështja e "Hardh Festit". Ka shumë thashetheme dhe zhurmë, por nuk kemi një informatë zyrtare. E para, kam lexuar që Ministria e Bujqësisë e ka tërhequr përkrahjen financiare për "Hardh Festin". A ka ndonjë informatë zyrtare, pse? E dyta, pjesa e koncertit është bërë me pagesë, 10€ për tri net. A nënkupton kjo që "Hardh Festi" nuk ka nevojë për qytetarët e Komunës së Rahovecit, apo ka filluar të kalojë në biznes? Mendoj që "Hardh Festi", përveç pjesës koncertale, e ka promovimin e verës, rrushit, trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore të Komunës së Rahovecit. Nëse fillojmë me pagesë, konsiderojmë që dalim përtej asaj që e kemi nisur. Në Statutin e Komunës, e kemi çështje statutare Ditën e Vjeljes së Rrushit dhe nuk mund askush të veprojë ndryshe, përpos asaj që Komuna e Rahovecit e obligon, sepse besoj që duhet të jetë në patronatin e kryetarit të Komunës. Kërkoj që në seancën e Asamblesë Komunale ta kemi si pikë shtesë: Informatë rreth organizimit të

“Hardh Festit”. Të jetë i pranishëm përfaqësuesi i OJQ-së, ose prej komunës, si dhe ta shohim se pse po ndodh kjo! Besoj që ata kanë arsyeshmëri apo shpjegim se pse është bërë me pagesë mbrëmja në “Hardh Fest”. Meqenëse është organizim statutar, mund të marrë vendim edhe Asambleja Komunale.

Kryesuesi: Faleminderit, Burim Krasniqi! Nëse nuk ka ndonjë gjë dikush tjetër, ju informoj që në mbledhjen e Kuvendit do t’i kemi edhe këto pika shtesë:

Shqyrtimi i informatës së punës së KKSBB-së për 6-mujorin e parë të vitit 2024;

Shqyrtimi i raportit të Performancës Komunale 2023;

Shqyrtimi i raportit 6-mujor i punës së kryetarit të Komunës. Në lidhje me propozimin e Burim Krasniqit, e vendosim në votim, kush është “për”?... Unanimisht, me 5 vota, votohet propozimi i Burimit që në seancën e qershorit të jetë si pikë shtesë informata rreth organizimit të “Hardh Festit”. Faleminderit, shihemi në mbledhjet e radhës!

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

